

20212874515

LIGJ I REALIZIMIT TË BUXHETIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT PËR VITIN 2022

1. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022 (në tekstin e mëtejme: “Buxheti”) realizohet sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 2

Shfrytëzuesit buxhetorë dhe individët shfrytëzues, janë të detyruar që mjetet e përcaktuara në buxhet t'i shfrytëzojnë me dedikim, në mënyrë racionale, ekonomike dhe efikase.

2. REALIZIMI I BUXHETIT BAZË

Neni 3

Shfrytëzuesit buxhetorë, të cilët në përbërjen e tyre kanë individë shfrytëzues, janë të detyruar ta kontrollojnë shfrytëzimin me dedikim dhe ligjor të mjeteve, me të cilat disponojnë individët shfrytëzues.

Neni 4

Shfrytëzuesit buxhetorë dhe individët shfrytëzues nuk guxojnë të marrin obligime ose të bëjnë shpenzime mbi limitin e mjeteve të miratuara me buxhet.

Neni 5

Teknika e arkëtimit të të hyrave, realizimi i shpenzimeve dhe menaxhimi me likuiditetin bëhet në pajtim me aktet e përcaktuara nga ministri i Financave.

Neni 6

Shfrytëzuesit buxhetorë nga pushteti qendror mund t'i shfrytëzojnë mjetet vetëm nëse në afat prej 25 ditësh nga dita e miratimit të buxhetit, në Thesarin e Ministrisë së Financave dorëzojnë plan financiar vjetor për tremujorë, për shfrytëzimin e mjeteve për llogari, programe, nënprograme dhe zëra.

Shfrytëzuesit buxhetorë nga pushteti qendror, të cilët në përbërjen e tyre kanë individë shfrytëzues, janë të detyruar që çdo individ shfrytëzues, në afat prej pesë ditësh nga dita e miratimit të buxhetit, t'i dorëzojnë ekstrakt nga plani financiar vjetor për llogari, programe, nënprograme dhe zëra, në të cilin janë të përmbajtura mjetet e miratuara për individët e veçantë shfrytëzues.

Në bazë të ekstraktit nga paragrafi (2) i këtij neni, individët shfrytëzues përpilojnë plan të tyre financiar për tremujorë, llogari, programe, nënprograme dhe zëra, të cilët kanë për obligim ta dorëzojnë në ministrinë kompetente, ndërsa ministria kompetente planin e konsoliduar financiar ta dorëzojë në Ministrinë e Financave në afat prej 25 ditësh nga dita e miratimit të buxhetit.

Gjatë vitit, shfrytëzuesit buxhetorë nga pushteti qendror mund të dorëzojnë kërkesë për ndryshimin e planit financiar vjetor për tremujorë, për shfrytëzimin e mjeteve për llogari, programe, nënprograme dhe zëra, për shpenzime të cilat nuk kanë mundur të planifikohen në kohë dhe për të këtë nevojitet të dorëzohet plan i reviduar financiar vjetor për tremujorë.

Në bazë të planit financiar vjetor, gjatë vitit, shfrytëzuesit buxhetorë nga pushteti qendror përpilojnë propozim-plan financiar për tremujor të dhënë, për muaj, llogari, programe, nënprograme dhe zëra, të cilin e dorëzojnë në Thesarin e Ministrisë së Financave, më së voni pesë ditë para fillimit të tremujorit me të cilin ka të bëjë plani, për miratim të tij.

Shfrytëzuesit buxhetorë nga pushteti qendror, të cilët në përbërjen e tyre kanë individë shfrytëzues janë të detyruar që në Thesarin e Ministrisë së Financave të dorëzojnë edhe plan tremujor përmbledhës për muaj, llogari, programe, nënprograme dhe zëra për individët e tyre shfrytëzues.

Gjatë tremujorit të dhënë, shfrytëzuesit buxhetorë nga pushteti qendror mund të dorëzojnë kërkesë për ndryshimin e planit financiar tremujor për muaj, llogari, programe, nënprograme dhe zëra, në kuadër të shumave të miratuara për tremujorin e dhënë.

Mjetet nga buxheti bazë në Ndarjen 090.02 - Ministria e Financave - Funksionet e shtetit shfrytëzohen pa miratimin e planit financiar.

Në rast kur Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut miraton mjete nga Ndarja 090.02 - Ministria e Financave - Funksionet e shtetit të një shfrytëzuesi tjetër buxhetor, mjetet miratohen si plan financiar (e drejta e shpenzimit) në ndarjen e shfrytëzuesit buxhetor.

Neni 7

Shfrytëzuesit buxhetorë të pushtetit qendror në tremujorin e parë të vitit aktual, janë të detyruar të realizojnë së paku 15% të shpenzimeve kapitale të planifikuara nga buxheti themelor i miratuar, duke përfshirë rishpërndarjet e mjeteve në zërat 480 - Blerja e pajisjeve dhe makinave, 481 - Objekte ndërtimore, 482 - Objekte të tjera ndërtimore, 483 - Blerja e mobiljeve dhe 486 - Blerja e automjeteve në nënprogramet përkatëse në buxhetet e tyre, me përjashtim të Programit M - Integrimi në BE dhe Nënprogramit BA - Integrimi në NATO.

Shfrytëzuesit buxhetorë të pushtetit qendror përfundimisht nga tremujori i dytë i vitit aktual janë të detyruar të realizojnë së paku 40% të shpenzimeve kapitale të planifikuara nga buxheti themelor i miratuar, duke përfshirë rishpërndarjet e mjeteve në zërat 480 - Blerja e pajisjeve dhe makinave, 481 - Objekte ndërtimore, 482 - Objekte të tjera ndërtimore, 483 - Blerja e mobiljeve dhe 486 - Blerja e automjeteve në nënprogramet përkatëse në buxhetet e tyre, me përjashtim të Programit M - Integrimi në BE dhe Nënprogramit BA - Integrimi në NATO.

Shfrytëzuesit buxhetorë të pushtetit qendror përfundimisht nga tremujori i tretë i vitit aktual janë të detyruar të realizojnë së paku 65% të shpenzimeve kapitale të planifikuara nga buxheti themelor i miratuar, duke përfshirë rishpërndarjet e mjeteve në zërat 480 - Blerja e pajisjeve dhe makinave, 481 - Objekte ndërtimore, 482 - Objekte të tjera ndërtimore, 483 - Blerja e mobiljeve dhe 486 - Blerja e automjeteve në nënprogramet përkatëse në buxhetet e tyre, me përjashtim të Programit M - Integrimi në BE dhe Nënprogramit BA - Integrimi në NATO.

Nëse shfrytëzuesit buxhetorë të pushtetit qendror nuk veprojnë në përputhje me paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni, për mjetet e pashfrytëzuara deri në kufirin e parashikuar (pjesën e mbetur deri në 15%, deri në 40% ose deri në 65%), Ministria e Financave e rishpërndan me detyrë zyrtare në zërin 414 - Rezervat për shpenzime kapitale brenda buxhetit të shfrytëzuesit buxhetor, pa të drejtë të shpenzimit.

Nëse shfrytëzuesit buxhetorë të pushtetit qendror përfundimisht nga tremujori i dytë i vitit aktual kanë realizuar 40% të shpenzimeve kapitale në nivelin e nënprogramit dhe zërit nga buxheti themelor i miratuar duke përfshirë rishpërndarjen e mjeteve, përkatësisht që në tremujorin e tretë të vitit aktual kanë realizuar 65% të shpenzimeve kapitale në nivel të nënprogramit dhe zërit nga buxheti themelor i miratuar, përfshirë rishpërndarjen e mjeteve, mjetet e rishpërndara nga paragrafi (4) i këtij neni, Ministria e Financave sipas detyrës zyrtare i kthen në nënprogramin përkatës dhe zërin nga i cili janë rishpërndarë.

Nëse shfrytëzuesit buxhetorë të pushtetit qendror përfundimisht nga 15 nëntori i vitit aktual kanë realizuar 70% të shpenzimeve kapitale në nivelin e nënprogramit dhe zërit nga buxheti themelor i miratuar duke përfshirë rishpërndarjen e mjeteve, mjetet e rishpërndara nga paragrafi (4) i këtij neni Ministria e Financave sipas detyrës zyrtare i kthen në nënprogramin përkatës dhe zërin nga i cili janë rishpërndarë.

Obligimet e parapara në paragrafët (1), (2), (3), (4), (5) dhe (6) të këtij neni nuk kanë të bëjnë me shfrytëzuesin buxhetor Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Me propozim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për shfrytëzimin e mjeteve nga pika 414 - Rezervat për shpenzime kapitale, të cilat nuk kthehen në përputhje me paragrafin (5) të këtij neni, vendos Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut me Vendim për rishpërndarjen e mjeteve ndërmjet shfrytëzuesve buxhetorë dhe fondeve ose me miratimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të buxhetit.

Nëse në afatet e parapara nga paragrafët (2), (3) dhe (6) të këtij neni përgatiten dhe miratohen ndryshime dhe plotësime të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin aktual, Ministria e Financave nuk vepron në pajtim me paragrafët (4), (5) dhe (6) të këtij neni.

Neni 8

Pagesën e rrogave të shfrytëzuesve buxhetorë nga pushteti qendror dhe individëve shfrytëzues e miraton Ministria e Financave.

Shfrytëzuesit buxhetorë nga pushteti qendror dhe individët shfrytëzues janë të detyruar që dy ditë para pagesës së rrogave, në Ministrinë e Financave të dorëzojnë kërkesë për miratimin e mjeteve për rroga, të cilës do t'ia bashkëngjitin formularin F-1 për numrin e të punësuarve me emër dhe mbiemër, rrogë si dhe të dhëna të tjera të parapara në formular në version të shkruar dhe elektronik (në CD, postë elektronike e të tjera), për muajin përkatës me të cilin ka të bëjë pagesa.

Në rast të punësimeve të reja, shfrytëzuesit buxhetorë nga pushteti qendror dhe individët shfrytëzues janë të detyruar që të dorëzojnë njoftim për mjetet e siguruar financiare dhe të parashtrojnë formular M-1.

Personi udhëheqës të shfrytëzuesi buxhetor është përgjegjës për sigurim se kërkesa e dorëzuar për miratim të mjeteve për rroga është në pajtim me rregullativën ligjore në fuqi.

Neni 9

Të punësuarit tek shfrytëzuesit buxhetorë të pushtetit qendror kanë të drejtë për një pagë shtesë në vlerë deri në 30% të vlerës së pagës themelore për shkak të specifikës së detyrave të punës dhe rritjes së ngarkesës së vëllimit të punës, nëse në buxhetin e shfrytëzuesit të buxhetit sigurohen mjete për këtë qëllim.

Shfrytëzuesit e buxhetit, kriteret për realizimin e së drejtës së shtesës dhe mënyrën e përcaktimit të vlerës së shtesës së përmendur në paragrafin (1) të këtij neni me propozim të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës, i përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Shtesa e pagës sipas paragrafit (1) të këtij neni, nuk u paguhet të punësuarve në shfrytëzuesit e buxhetit nga pushteti qendror, të cilëve u është caktuar e drejta e shtesës së pagës me ligj të veçantë dhe/ose marrëveshje kolektive, përveç shtesave lidhur me pagën për punë gjatë ndërrimit të natës, punë me ndërrime (turne), punë gjatë pushimit javor, punë gjatë festave të përcaktuara me ligj dhe punë më të gjatë se orari i plotë i punës.

Neni 10

Të punësuarit në shfrytëzuesit buxhetorë nga pushteti qendror që punojnë në organet dhe strukturat për menaxhimin e instrumentit për ndihmë paraaderuese IPA dhe të drejtën e pagës e realizojnë me kushtet dhe kriteret e përcaktuara me Ligjin e Nëpunësve Administrativ, kanë të drejtë për pagë shtesë në vlerë prej 15% të vlerës së pagës themelore.

Neni 11

Funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar te shfrytëzuesit buxhetorë dhe individët shfrytëzues nga dita e emërimit të tyre përfundimisht me ditën e shkarkimit të tyre, u takon kompensim i shpenzimeve për jetë të ndarë nga familja në shumë prej 30% nga rroga mesatare mujore neto e paguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut në tre muajt paraprakë.

Jetë e ndarë nga familja konsiderohet kur personat sipas paragrafit (1) të këtij neni, të cilët kanë në përkujdesje familje, krijojnë marrëdhënie pune në organin e administratës jashtë vendbanimit të tyre, ndërsa në vendin ku është selia e organit në të cilin kanë krijuar marrëdhënie pune nuk jetojnë me familjen e tyre.

Kompensimi i shpenzimeve për jetë të ndarë nuk u takon personave nga paragrafi (1) i këtij neni, nëse vendbanimi është në largësi më pak se 100 kilometra nga vendi i punës.

Funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar te shfrytëzuesit buxhetorë dhe individët shfrytëzues, të cilët shfrytëzojnë kompensim për jetë të ndarë nga familja nuk u takon kompensim për shpenzime për transport për shkak të vizitës së familjes më të ngushtë.

Neni 12

Personave, të cilëve u takon e drejta e shfrytëzimit të banesës zyrtare në pajtim me ligjin, nëse ajo nuk mund t'u sigurohet, kanë të drejtë kompensimi për qiranë e banesës. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut do ta caktojë shumën e kompensimit për qiranë e banesës.

Kompensimi i shpenzimeve për jetë të ndarë dhe kompensimi për qiranë e banesës përjashtohen reciprokisht.

Neni 13

Dispozitat e neneve 11 dhe 12 të këtij ligji, zbatohen edhe ndaj personave me shërbim në Armatën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në Ministrinë e Punëve të Brendshme, të cilëve u takojnë këto të drejta në pajtim me ligjin.

Neni 14

Për ditët kur i punësuari është në udhëtim zyrtar, pushim mjekësor, pushim vjetor dhe mungon nga puna për çfarëdo qoftë baze tjetër, kompensimi për jetë të ndarë nuk paguhet.

Neni 15

Kompensimi për shpenzime të shpërnguljes, personave të cilëve u takon e drejta e shfrytëzimit të banesës zyrtare, u paguhet në shumë të shpenzimeve reale për transportin e orendive.

Kompensimi për shpenzime të shpërnguljes nuk i takon nëse të punësuarit i paguhet kompensim për jetë të ndarë.

Neni 16

Në rast të pushimit mjekësor të pandërprerë më gjatë se gjashtë muaj, të punësuarit i paguhet ndihmë e njëhershme në para në shumë prej një rroge të fundit të paguar neto mujore mesatare në organin ku është i punësuar.

Neni 17

Mëditja për udhëtim zyrtar në vend llogaritet nga ora e nisjes së punëtorit në udhëtim zyrtar deri në orën e kthimit me mjetin e transportit si vijon:

- mëditje në shumë prej 700 denarë, nëse udhëtimi zyrtar ka zgjatur më shumë se 12 orë dhe
- mëditje në shumë prej 350 denarë, nëse udhëtimi zyrtar ka zgjatur nga 8 deri 12 orë.

Neni 18

Mëditja e udhëtimit zyrtar në vend për të punësuarit e Ministrisë së Brendshme, Agjencisë së Zbulimit, Agjencisë së Sigurisë Nacionale dhe Policisë Financiare, llogaritet nga momenti i nisjes së të punësuarit në një udhëtim zyrtar deri në momentin e kthimit me automjet, si vijon:

- mëditje në shumë prej 2.000 denarë, nëse udhëtimi zyrtar ka zgjatur më shumë se 12 orë dhe
- mëditje në shumë prej 1.000 denarë, nëse udhëtimi zyrtar ka zgjatur 8 deri 12 orë dhe.

Neni 19

Në rast të shkuarjes së punëtorit në pension, i paguhet shuma e dyfishtë e kompensimit të njëhershëm, e përlllogaritur në bazë të rrogës mesatare mujore neto për punëtor në Republikë, e shpallur deri në ditën e pagesës.

Neni 20

Në rast të vdekjes së të punësuarit, familjes së tij i takon ndihmë me para në shumë të shumës së dyfishtë të rrogës mesatare mujore neto për punëtor në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Të punësuarit, në rast të vdekjes së anëtarit të familjes më të ngushtë (prind, bashkëshort/e, fëmijë të lindur në martesë ose jashtë martese, fëmijë të birësuar, fëmijë të adoptuar dhe fëmijë të marrë në mbajtje) i takon ndihmë me para në shumë të një rroge mesatare mujore neto për punëtor në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Kompensimet nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, paguhen pas kërkesës së parashtruar paraprakisht me dokumentacionin e kompletuar në vitin e ndodhjes së vdekjes, përkatësisht në vitin që vijon pas vitit të ndodhjes së vdekjes.

Për punëtorët e angazhuar me marrëveshje për kalimin e punëtorit për punësime të përkohshme, mjetet për pagesën e ndihmës solidarë të të punësuarve i siguron punëdhënësi, ndërsa pagesën e kryen Agjencia e Punësimeve të Përkohshme.

Neni 21

Shfrytëzuesit buxhetorë, të drejtat e fituara në bazë të neneve 11, 12, 15, 16, 17, 18 dhe 19 të këtij ligji, i paguajnë nga mjetet e miratuara me buxhet.

Neni 22

Shfrytëzuesit buxhetorë dhe individët shfrytëzues të mjeteve nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërmarrjet publike, agjencitë dhe subjektet juridike-publike të themeluara nga pushteti qendror, si dhe shoqëritë tregtare të themeluara nga Republika e Maqedonisë së Veriut, përveç trupave rregullatorë të pavarur me autorizime publike të përcaktuara me ligj, mund të punësojnë punëtorë me kohë të caktuar, me kohë të pacaktuar dhe të lidhin marrëveshje për kalim të punëtorit për punësime të përkohshme për kryerjen e punëve të përkohshme, vetëm me kusht që për këtë të jenë siguruar mjete financiare në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht në planet financiare për vitin fiskal aktual.

Ministria e Financave në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të kërkesës për punësimin e punëtorëve të rinj, i njofton me shkrim subjektet sipas paragrafit (1) të këtij neni, për mjetet e siguruara financiare për punësimet e kërkuara.

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut për pëlqim për mjete të siguruara financiare, vepron në pajtim me Ligjin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

2.1 REALIZIMI I SHPENZIMEVE TË VEÇANTA TË PËRCAKTUARA NË BUXHETIN BAZË

Neni 23

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 040.01 - Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Nënprogrami S5 – Zhvillimi i gjelbër, shfrytëzohen për projekte nga fusha e mjedisit jetësor dhe energjetika sipas programit paraprak të miratuar, më së voni deri më 31 mars 2022 nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Sekretariatit të Përgjithshëm të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 040.01 - Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Programi 10 – Administrata, zëri 463-Transfere te organizatat joqeveritare, shfrytëzohen me vendim paraprak të miratuar, nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Sekretariatit të Përgjithshëm të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 24

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 040.02-Shërbimi për punë të përgjithshme dhe të përbashkëta i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Nënprogrami 1A-Rikonstruktimi i ndërtesave të organeve qeveritare, shfrytëzohen sipas programit të miratuar paraprakisht nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozimin e shërbimit për punë të përgjithshme dhe të përbashkëta të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 25

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 040.10-Ministria për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive, Nënprogrami 11-Promovimi i marrëdhënieve ndëretnike, zëri 463-Transfere për organizatat joqeveritare, të dedikuara për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave të qytetarëve dhe fondacioneve, do të shfrytëzohen në bazë të vendimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Ministrisë për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive.

Shoqatat dhe fondacionet në Ministrinë për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive dorëzojnë programe për dedikimin e mjeteve të kërkuara, pas shpalljes së publikuar paraprake.

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 040.10 - Ministria për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive, Nënprogrami 12 – Shënimi i përvjetorit të Marrëveshjes Kornizë, zëri 425-Shërbime kontratuese shfrytëzohen sipas programit të miratuar paraprakisht nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Ministrisë për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive.

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 040.10-Ministria për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive, Nënprogrami K5-Përfaqësimi adekuat dhe i drejtë i bashkësive, do të shfrytëzohen për punësimin e pjesëtarëve të bashkësive të shfrytëzuesit buxhetor dhe individët shfrytëzues të pushtetit qendror, pas lejes paraprake të Trupit Koordinues për përfaqësim adekuat dhe të drejtë, të formuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 26

Në Ndarjen 090.02 - Ministria e Financave - Funksionet e shtetit, Nënprogrami 20 - Funksionet, zëri 426 - Shpenzime tjera aktuale sigurohen mjete për pagesën e provizioneve për qarkullim pagesor dhe për shërbime të kryera, kompensime për komisione dhe shpenzime tjera.

Neni 27

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 090.02 - Ministria e Financave - Funksionet e shtetit, Nënprogrami 20 - Funksionet, kategoritë 45 - Pagesa e kamatave dhe 49 - Pagesa e kryegjësë, për pagesën e kamatës dhe kryegjësë në bazë të borxhit të huaj dhe vendor, si dhe mjetet e përcaktuara në Nënprogramin 20 - Funksionet, zëri 485 - Investime dhe mjete jofinanciare të dedikuara për pagesën e garancive të shtetit në pajtim me dispozitat nga marrëveshjet e lidhura, si dhe huatë afatshkurtra, të cilat kthehen deri në fund të vitit fiskal realizohen pa marrë parasysh alokimin e planifikuar buxhetor për këtë dedikim.

Neni 28

Mjetet për financimin e projekteve nga komponentët e veçantë nga IPA (kofinancimi nacional dhe mjetet e IPA-së nga BE-ja), në mënyrë indikative janë planifikuar në Ndarjen 090.02 - Ministria e Financave - Funksionet e shtetit, përveç mjeteve për kofinancim nacional të komponentit të pestë nga IPA - Zhvillimi rural të cilat janë planifikuar në Ndarjen 140.04 - Agjencia e Përkrahjes Financiare të Bujqësisë dhe të Zhvillimit Rural dhe Ndarjen 140.01 - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

Gjatë transferimit jo me kohë të mjeteve nga BE-ja të dedikuara për financimin e projekteve nga komponentët e veçantë të IPA-së, mjetet do të sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut në pajtim me procedurat interne të Ministrisë së Financave.

Gjatë realizimit, përparësi në pagesën e mjeteve do të ketë financimi i projekteve nga komponentët e veçantë të IPA-s.

Neni 29

Në Ndarjen 090.02 - Ministria e Financave - Funksionet e shtetit, Nënprogrami 20 - Funksionet, zëri 465 - Pagesa për dokumente përmbartuese, sigurohen mjete për pagesën e dokumenteve përmbartuese në rast debitor është Republika e Maqedonisë së Veriut. Këto mjete realizohen pa marrë parasysh alokimin e planifikuar buxhetor për këtë dedikim.

Neni 30

Në Ndarjen 090.02 - Ministria e Financave - Funksionet e shtetit, Nënprogrami 20 - Funksionet, zëri 480 - Blerja e pajisjeve dhe makinave, sigurohen edhe mjete për kthimin e tatimit mbi vlerën e shtuar gjatë realizimit të donacionit me interes publik si dhe mjetet për kthim të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe akcizave për realizim të projekteve në bazë të marrëveshjeve ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe donatorëve të huaj, në të cilat qëndron klauzola se mjetet e dhuruara nuk mund të shfrytëzohen për pagesën e tatimeve. Këto mjete realizohen pa marrë parasysh alokimin e planifikuar buxhetor për këtë dedikim.

Rregullat më të përafërta për mënyrën e zbatimit të dispozitave sipas paragrafit (1) të këtij neni i miraton ministri i Financave.

Neni 31

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 100.01 - Ministria e Ekonomisë, Nënprogrami D0 - Përkrahja e turizmit vendor për punëtorë me të hyra të ulëta, zëri 464 - Transfere të ndryshme, shfrytëzohen sipas programit të miratuar paraprakisht nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Ministrisë së Ekonomisë.

Neni 32

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 130.01 - Ministria e Transportit dhe e Lidhjeve, Nënprogrami 20 - Komunikacioni dhe komunikime, zëri 464 - Transfere të ndryshme, shfrytëzohen sipas programit paraprakisht të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve.

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 130.01 - Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, Nënprogrami 30 - Urbanizëm dhe ndërtimtari, zëri 482 - Objekte tjera ndërtimore shfrytëzohen sipas programit të miratuar paraprakisht nga ministri i Transportit dhe i Lidhjeve.

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 130.01 - Ministria e Transportit dhe e Lidhjeve, Nënprogrami DA - Investime në infrastrukturën hekurudhore, zëri 489 - Subvencione kapitale për ndërmarrjet dhe organizatat joqeveritare shfrytëzohen sipas programit të miratuar vjetor për financimin e infrastrukturës hekurudhore nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut me propozim të drejtorit të infrastrukturës.

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 130.01 - Ministria e Transportit dhe e Lidhjeve, Nënprogrami DA - Investime në infrastrukturën hekurudhore, të planifikuara në zërin 461 - Subvencione për ndërmarrjet publike, shfrytëzohen në pajtim me vendimin e miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut me propozim të Ministrisë së Transportit dhe të Lidhjeve.

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 130.01 - Ministria e Transportit dhe e Lidhjeve, Nënprogrami 3B - Ujësjiellësi dhe kanalizimi për komunitet, zëri 425 - Shërbime kontratuese dhe zëri 488 - Dotacione kapitale për NJVL-në, realizohen pa marrë parasysh alokimin e planifikuar buxhetor për këtë dedikim gjatë vitit dhe të njëjtat refundohen nga llogaria për hua dhe llogaria për donacione për dedikimin e njëjtë në Ndarjen 130.01 - Ministria e Transportit dhe e Lidhjeve.

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 130.01 - Ministria e Transportit dhe e Lidhjeve, Nënprogrami 11 - Mbështetje për zbatimin e Dekadës dhe Strategjisë për Romët, zëri 488 - Dotacione kapitale në NJVL-në, shfrytëzohen sipas programit të miratuar paraprak nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Ministrisë së Transportit dhe të Lidhjeve.

Shpërndarjen e mjeteve sipas paragrafit (6) të këtij neni e realizon Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut me vendim, ndërsa me propozim të Ministrisë së Transportit dhe të Lidhjeve.

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 130.01 - Ministria e Transportit dhe e Lidhjeve, Nënprogrami 2M-Investime në infrastrukturën rrugore, zëri 489 Subvencione kapitale për ndërmarrjet dhe organizatat joqeveritare shfrytëzohen sipas programit të miratuar paraprak nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Ndërmarrjes publike për rrugë shtetërore pas pranimit të mendimit paraprak nga Ministria e Transportit dhe e Lidhjeve.

Nëse deri në fund të muajit nëntor në vitin aktual, nuk bëhet refundimi i mjeteve sipas paragrafit (5) të këtij neni, Thesari me detyrë zyrtare bën ridedikimin e mjeteve nga Buxheti i Ndarjes 130.01 - Ministria e Transportit dhe e Lidhjeve, nga të gjitha zërat dhe programet.

Neni 33

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 140.01 - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, Nënprogrami 30 - Bujqësia, zëri 489 - Subvencione kapitale për ndërmarrjet dhe organizatat joqeveritare, do të shfrytëzohen sipas programit të miratuar paraprakisht nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 140.01 - Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave, Nënprogrami 34 - Zhvillimi rural, zëri 464 - Transfere të ndryshme, do të shfrytëzohen sipas programit të miratuar paraprak nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 140.01 - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, Nënprogrami 51 - Mbrojtja e bimëve, zëri 464 - Transferte të ndryshme, shfrytëzohen sipas programit të miratuar paraprakisht nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 140.01 - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, Nënprogrami 60 – Ujësjiellësi, zëri 482 - Objekte tjera ndërtimore dhe shfrytëzohen sipas programit të miratuar paraprak nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 140.01 - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, Nënprogrami 6G - Programi për ujitjen e luginës jugore të Vardarit, zëri 425 - Shërbime kontratuese dhe zëri 482 - Objekte të tjera ndërtimore dhe në nënprogramin 6D Programi për ujitje të Maqedonisë së Veriut zëri 482 - Objekte tjera ndërtimore, realizohen pa marrë parasysh alokimin e planifikuar buxhetor për këtë dedikim gjatë vitit dhe këto refundohen nga llogaria për hua për dedikimin e njëjtë në ndarjen 140.01 - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

Nëse deri në fund të muajit nëntor në vitin aktual, nuk bëhet refundimi i mjeteve sipas paragrafit (5) të këtij neni, Thesari me detyrë zyrtare bën ridedikimin e mjeteve nga Buxheti i ndarjes 140.01 - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, nga të gjitha zërat dhe programet.

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 140.01 - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, Nënprogrami MD – Zhvillimi rural, zëri 425 – Shërbime kontratuese, realizohen pa marrë parasysh alokimin e planifikuar buxhetor për këtë dedikim gjatë vitit dhe këto refundohen pjesërisht nga llogaria për donacione në Ndarjen 09.002 - Ministria e Financave - Funksionet e shtetit, Nënprogrami MD – Zhvillimi rural.

Nëse deri në fund të muajit nëntor në vitin aktual nuk bëhet refundimi i mjeteve nga paragrafi (7) i këtij neni, Thesari me detyrë zyrtare bën ridedikimin e mjeteve nga Buxheti i ndarjes 140.01 - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

Neni 34

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 140.04 - Agjencia për Mbështetje Financiare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Nënprogrami 20 - Mbështetje financiare në bujqësi, zëri 464 - Transfere të ndryshme, Nënprogrami 21-Fondi intervenues për bujqësi, zëri 464-Transfere të ndryshme, si dhe mjetet e përcaktuara në Programin 2A-Mbështetje financiare të zhvillimit rural, zëri 489-Subvencione kapitale për ndërmarrjet dhe organizatat joqeveritare, shfrytëzohen sipas programeve të miratuara paraprakisht nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

Neni 35

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 140.05 - Agjencia e Ushqimit dhe e Veterinarisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Nënprogrami 20 - Mbrojtje shëndetësore veterinerë, zëri 464 - Transfere të ndryshme, Nënprogrami 30 - Siguria e ushqimit, zëri 464 - Transfere të ndryshme dhe Nënprogrami 40 - Shëndeti publik veteriner, zëri 464 - Transfere të ndryshme do të shfrytëzohen sipas programeve të miratuara paraprakisht nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut me propozim të Agjencisë së Ushqimit dhe të Veterinarisë të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 36

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 150.01 - Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale, Nënprogrami 10 – Administrata, zëri 463 - Transfere në organizatat joqeveritare, do të shfrytëzohen me Vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për financim të

aktiviteteve programore të organizatave invalidore nacionale, shoqatave të tyre dhe asociacionit të tyre, shoqatave të qytetarëve për luftë kundër dhunës familjare dhe Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në pajtim me Ligjin e Lojërave të Fatit dhe të Lojërave Argëtuese.

Neni 37

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 150.01 - Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale, Nënprogrami 3A – Ndërtimi, pajisja dhe mirëmbajtja e objekteve për mbrojtje të fëmijëve, shfrytëzohen sipas programit të miratuar paraprakisht për ndërtim, pajisje dhe mirëmbajtje të objekteve për mbrojtje të fëmijëve nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim nga Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale.

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 150.01 - Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale, Nënprogrami 4A – Ndërtimi, pajisja dhe mirëmbajtja e objekteve për mbrojtje sociale dhe shtëpive për persona të moshuar shfrytëzohen sipas programit të miratuar paraprakisht për ndërtim, pajisje dhe mirëmbajtje të objekteve për mbrojtje sociale dhe shtëpive për persona të moshuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim nga Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale.

Neni 38

Mjetet për mbrojtjen e popullatës së rrezikuar sociale të përcaktuara në Ndarjen 150.01 - Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale, Nënprogrami 50 - Kompensime për mbrojtje sociale, zëri 471 - Kompensime sociale, do të shfrytëzohen sipas programit të miratuar paraprakisht nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe dokumentacionit të kompletuar nga qendrat për punë sociale.

Neni 39

Mjetet për pagesën e shtesës fëmijërore dhe prindërore të përcaktuara në Ndarjen 150.01 - Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale, Nënprogrami 52 - Kompensime për mbrojtje sociale, zëri 471 - Kompensime sociale, do të shfrytëzohen sipas programit të miratuar paraprakisht nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe dokumentacionit të kompletuar nga Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale.

Neni 40

Mjetet për realizimin e obligimeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut në bazë të sigurimit pensional dhe invalidor të përcaktuara me ligj, në Ndarjen 150.01 - Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale, Nënprogrami 60 - Përkrahja e fondeve sociale, zëri 431 - Transfere për Fondin për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut i paguhen Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut pas përllogaritjes paraprakisht të dorëzuar nga Fondi në Ministrinë e Punës dhe të Politikës Sociale.

Neni 41

Mjetet për realizimin e obligimeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut në bazë të sigurimit pensional me financim kapital të përcaktuara me ligj, në Ndarjen 150.01 - Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale, Nënprogrami 61 - Shpenzime tranzicioni në bazë të reformës pensionale, zëri 431 - Transfere për Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut i paguhen Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut pas përllogaritjes paraprakisht të dorëzuar nga Fondi në Ministrinë e Punës dhe të Politikës Sociale.

Neni 42

Shfrytëzuesi buxhetor i buxhetit qendror gjatë rindarjes së mjeteve në kuadër të buxhetit të miratuar, e që kanë të bëjnë me zmadhimin ose zvogëlimin e zërave të shpenzimit 431 - Transfere për Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut, doemos në mënyrë përkatëse duhet të sigurojë edhe rindarje të mjeteve të përcaktuara në buxhetin e fondit.

Neni 43

Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë së Veriut në Ministrinë e Financave dorëzon raport gjysmëvjetor dhe vjetor me arsyetim për shumën dhe dedikimin e mjeteve të shfrytëzuara nga nenet 38 dhe 39 të këtij ligji, si dhe arsyetim për masat e marra dhe të planifikuara për zmadhimin e arkëtimit të të hyrave tatimore dhe jotatimore në kompetencë të tij dhe propozime për zvogëlimin e transfereve, më së voni një muaj pas përfundimit të periudhës raportuese.

Neni 44

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 160.01 - Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Nënprogrami TA - Ndërtimi i shkollave fillore dhe TB - Rikonstruktimi i shkollave fillore, shfrytëzohen sipas programit të miratuar paraprakisht për ndërtim dhe rikonstruktim të shkollave fillore nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës.

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 160.01 - Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Nënprogrami TG - Ndërtimi i shkollave të mesme dhe TD - Rikonstruktimi i shkollave të mesme, shfrytëzohen sipas programit të miratuar paraprakisht për ndërtim dhe rikonstruktim të shkollave të mesme nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës.

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 160.01 - Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Nënprogrami 50-Standardi i nxënësve, Nënprogrami TI - Rikonstruktimi i konvikteve të nxënësve, Nënprogrami 60-Standardi i studentëve dhe Nënprogrami TK - Ndërtimi dhe rikonstruktimi i konvikteve studentore shfrytëzohen sipas programeve të miratuara paraprakisht nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës.

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 160.01 - Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Nënprogrami 71 - Puna shkencore-hulumtuese, shfrytëzohen sipas programit të miratuar paraprakisht për veprimtari shkencore-hulumtuese nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës.

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 160.01 - Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Nënprogrami TLL – Rehabilitimi efikas energjetik i konvikteve studentore, zëri 420-Shpenzime rrugore dhe ditore, zëri 421-Shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport, zëri 423-Materiale dhe inventar i imët, zëri 424 –Riparime dhe mirëmbajtje aktuale, zëri 425-shërbime kontratuese, zëri 426-shpenzime të tjera aktuale dhe zëri 482 –Objekte të tjera ndërtimore, shfrytëzohen pa marrë parasysh alokimin e planifikuar buxhetor për këtë dedikim gjatë vitit dhe të njëjtat refundohen nga llogaria për hua dhe llogaria për donacione për dedikimin e njëjtë në ndarjen 160.01-Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

Nëse deri në fund të muajit nëntor në vitin aktual nuk bëhet refundimi i mjeteve sipas paragrafit (5) të këtij neni, Thesari me detyrë zyrtare bën ridedikimin e mjeteve nga Buxheti i ndarjes 160.01 - Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, nga të gjitha zërat dhe programet.

Neni 45

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 161.01 - Agjencia e të Rinjve dhe e Sportit, Nënprogrami 20 - Sporti, zëri 463 - Transfere për organizatat joqeveritare shfrytëzohen për financimin e sportit, për federatat dhe klubet sportive, në pajtim me Ligjin e Lojërave të Fatit dhe të Lojërave Argëtuese.

Ndarjen e mjeteve sipas paragrafit (1) të këtij neni, e bën Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut me vendim, në bazë të programit të parashtruar nga Agjencia e të Rinjve dhe e Sportit.

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 161.01 - Agjencia e të Rinjve dhe e Sportit, Nënprogrami 40 - Programi ndërkombëtar, zëri 463 - Transfere për organizatat joqeveritare shfrytëzohen sipas programit të miratuar paraprakisht për zhvillim të sportit dhe të rinjve nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Agjencisë së të Rinjve dhe të Sportit.

Neni 46

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 190.01 - Ministria e Shëndetësisë, Nënprogramet 40, 50, 51, 52, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, 68 dhe 69 shfrytëzohen sipas programeve të miratuara paraprakisht nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Ministrisë së Shëndetësisë.

Ndarjen e mjeteve të përcaktuara në Nënprogramin 68 - Mjekim spitalor pa arkëtim të participimit për pensionistët dhe kategoritë e caktuara sociale, Ministria e Shëndetësisë e planifikon në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe të Politikës Sociale.

Neni 47

Mjetet e përcaktuara në ndarjen 191.01 - Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, Nënprogrami OA - Zhvillimi i barabartë rajonal, zëri 464 - Transfere të ndryshme, shfrytëzohen sipas programit të miratuar paraprakisht nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale.

Mjetet e përcaktuara në ndarjen 280.01 - Byroja për Zhvillim Rajonal, Nënprogrami OA - Zhvillimi i barabartë rajonal, zëri 488 - Dotacione kapitale për NJVL-në, shfrytëzohen sipas programit të miratuar paraprakisht nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Byrosë për Zhvillim Rajonal.

Neni 48

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 090.02 - Ministria e Financave - Funksionet e shtetit, Nënprogrami A0 - Decentralizimi, zëri 441 - Dotacione nga TVSH-ja, barten në llogaritë e komunave në bazë të urdhëresës së miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 49

Mjetet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për dotacione me dedikim dhe bllok dotacione barten në llogaritë e komunave në bazë të urdhëresave të miratuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në dinamikë të harmonizuar me Ministrinë e Financave.

Mjetet e pashfrytëzuara sipas paragrafit (1) të këtij neni, komunat i kthejnë në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut më së voni deri më 31.12. 2022.

Neni 50

Shfrytëzuesit buxhetorë, të cilët janë të obliguar të përpilojnë programe për shfrytëzimin e mjeteve nga buxheti, janë të detyruar që në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut t'i dorëzojnë ato në afat prej 30 ditësh nga dita e botimit të buxhetit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut është e detyruar që t'i miratojë programet nga paragrafi (1) i këtij neni në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit nga shfrytëzuesit buxhetorë.

Shfrytëzuesit buxhetorë në Ministrinë e Financave dorëzojnë raport gjysmëvjetor dhe vjetor për realizimin e programeve, më së voni një muaj pas përfundimit të periudhës raportuese.

Neni 51

Kthimi i të hyrave të cilat i takojnë Buxhetit, kryhet në rast kur bëhet fjalë për të hyra të paguara gabimisht, të hyra të paguara, përkatësisht të arkëtuara më shumë, si dhe për të hyra të paguara për të cilat nuk është krijuar veprim juridik.

Ridedikimi i të hyrave të cilat i takojnë buxhetit, kryhet vetëm kur bëhet fjalë për të hyra të paguara gabimisht.

Kthimi, përkatësisht ridedikimi i të hyrave sipas paragrafëve (1) dhe (2), përveç të hyrave nga paragrafët (4), (5) dhe (6) të këtij neni, kryhet me aktvendim të Ministrisë së Financave. Me përjashtim, për gabime të bëra gjatë kryerjes së qarkullimit pagesor, kthimin, përkatësisht ridedikimin me urdhëresë e kryen Thesari, pas kërkesës me shkrim nga bartësi i qarkullimit pagesor dhe dëshmisë për gabimin e bërë.

Kthimi, përkatësisht ridedikimi i të hyrave për të cilat është kompetente Drejtoria e të Hyrave Publike, kryhet me aktvendim të Drejtorisë së të Hyrave Publike. Me përjashtim, për gabimet e bëra gjatë kryerjes së qarkullimit pagesor, kthimin, përkatësisht ridedikimin me urdhëresë e kryen Drejtoria e të Hyrave Publike pas kërkesës me shkrim nga bartësi i qarkullimit pagesor dhe dëshmisë për gabimin e bërë.

Kthimi, përkatësisht ridedikimi i të hyrave për të cilat kompetente është Drejtoria Doganore, kryhet me aktvendim të Drejtorisë Doganore. Me përjashtim për gabimet e bëra gjatë kryerjes së qarkullimit të pagesor, kthimin, përkatësisht ridedikimin me urdhëresë e kryen Drejtoria Doganore, pas kërkesës me shkrim nga bartësi i qarkullimit pagesor dhe dëshmisë për gabimin e bërë.

Kthimi, përkatësisht ridedikimi i të hyrave të cilat me veprimtarinë e tyre i realizojnë organet e administratës shtetërore në llogari të veçanta, bëhet me aktvendim të funksionarit, i cili e udhëheq organin. Me përjashtim për gabimet e shkaktuara gjatë kryerjes së qarkullimit pagesor, kthimin, përkatësisht ridedikimin me urdhëresë, e kryejnë organet administratës shtetërore, pas kërkesës me shkrim nga bartësi i qarkullimit pagesor dhe dëshmisë për gabimin e bërë.

Në procedurë për të hyra të paguara gabimisht, të hyra të paguara, përkatësisht të arkëtuara më shumë, si dhe për të hyra për të cilat nuk është krijuar veprim juridik, nuk përllogaritet kamatë, nëse me ligj tjetër nuk është rregulluar ndryshe.

Mënyrën e veprimit gjatë realizimit të kthimit, përkatësisht ridedikimit sipas këtij neni, e përcakton ministri i Financave.

Neni 52

Afati për përfundimin e procedurës për kthim, përkatësisht ridedikim të të hyrave, nuk mund të jetë më i gjatë se 60 ditë nga dita e pranimit të kërkesës për kthim, përkatësisht nga dita e kompletimit të dokumentacionit në lidhje me kërkesën për kthim, përkatësisht ridedikim të të hyrave.

Neni 53

E drejta për kthim, vjetërohet në afat prej pesë vjetësh nga dita kur ato janë paguar, përkatësisht nga dita e zbulimit që ato janë paguar më shumë ose gabimisht ose veprimi nuk është kryer, nëse me ligj tjetër nuk është rregulluar ndryshe.

3. REALIZIMI I BUXHETEVE TË AKTIVITETEVE VETËFINANCUESE, DONACIONEVE DHE HUAVE

Neni 54

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 090.04 - Agjencia e Rezervave të Mallrave, Nënprogrami 20 - Menaxhimi i rezervave të mallrave, zëri 484 - Mallra strategjike dhe rezerva të tjera, shfrytëzohen sipas programit të miratuar paraprakisht për formimin e rezervave të mallrave për vitin 2022 nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Agjencisë së Rezervave të Mallrave.

Neni 55

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 090.07 - Agjencia e Rezervave të Detyrueshme të Naftës-MAKORA, Nënprogrami 20 - Rezerva të detyrueshme të naftës dhe derivateve të naftës, zëri 484 - Mallra strategjike dhe rezerva të tjera, shfrytëzohen sipas programit të miratuar paraprakisht për formimin e rezervave të detyrueshme të naftës dhe derivateve të naftës për vitin 2022 nga Bordi Drejtues i Agjencisë së Rezervave të Detyrueshme të Naftës.

Neni 56

Të hyrat e realizuara nga aktivitetet vetëfinancuese, nga donacionet dhe huatë, shfrytëzuesit buxhetorë nga pushteti qendror mund t'i shfrytëzojnë për dedikimet dhe në shumë të shumave të përcaktuara me Buxhetin në bazë të planit financiar vjetor për tremujorë, llogari, programe, nënprograme dhe zëra dhe ai nevojitet të dorëzohet në Thesarin e Ministrisë së Financave në afat prej 25 ditësh nga dita e miratimit të buxhetit.

Shfrytëzuesit buxhetorë nga pushteti qendror, të cilët në përbërjen e tyre kanë individë shfrytëzues, janë të detyruar që çdo individ shfrytëzues, në afat prej pesë ditësh nga dita e miratimit të buxhetit, t'i dorëzojnë ekstrakt nga plani financiar vjetor për tremujorë, llogari, programe, nënprograme dhe zëra, në të cilin janë të përmbajtura mjetet e miratuara për individët e veçantë shfrytëzues.

Në bazë të ekstraktit sipas paragrafit (2) të këtij neni, individët shfrytëzues përpilojnë plan të tyre financiar për tremujorë, llogari, programe, nënprograme dhe zëra, të cilët e kanë për obligim që ta dorëzojnë në ministrinë kompetente dhe në Ministrinë e Financave në afat prej 25 ditësh nga dita e miratimit të buxhetit.

Gjatë vitit shfrytëzuesit buxhetorë nga pushteti qendror mund të dorëzojnë kërkesë për ndryshimin e planit financiar vjetor për tremujorë, për shfrytëzimin e mjeteve për llogari, programe, nënprograme dhe zëra, për shpenzime të cilat nuk kanë mundur të planifikohen në kohë dhe për këtë nevojitet që shfrytëzuesit buxhetorë nga pushteti qendror të dorëzojnë plan të reviduar financiar vjetor për tremujorë.

Në bazë të planit financiar vjetor, gjatë vitit, shfrytëzuesit buxhetorë nga pushteti qendror përpilojnë propozim-plan financiar për tremujorin e dhënë, për muaj, llogari, programe, nënprograme dhe zëra, të cilin e dorëzojnë në Thesarin e Ministrisë së Financave, më së voni pesë ditë para fillimit të tremujorit me të cilin ka të bëjë plani, për miratim të tij.

Shfrytëzuesit buxhetorë nga pushteti qendror, të cilët në përbërjen e tyre kanë individë shfrytëzues janë të detyruar që në Thesarin e Ministrisë së Financave të dorëzojnë edhe plan përmbledhës tremujor për muaj, për llogari, programe, nënprograme dhe zëra, për individët e tyre shfrytëzues.

Gjatë tremujorit të dhënë, shfrytëzuesit buxhetorë nga pushteti qendror mund të dorëzojnë kërkesë për ndryshimin e planit financiar tremujor për muaj, llogari, programe, nënprograme dhe zëra, në kuadër të shumave të miratuara për tremujorin e dhënë.

Neni 57

Rindarja e mjeteve të përcaktuara në llogaritë e veçanta, ndërmjet zërave të shpenzimit, programeve dhe nënprogrameve në kuadër të buxhetit të shfrytëzuesit buxhetor, bëhet me pëlqim paraprak të ministrit të Financave.

4. MBAJTJA E EVIDENCËS SË OBLIGIMEVE TË MARRA TË SHFRYTËZUESVE BUXHETORË

Neni 58

Shfrytëzuesit buxhetorë mbajnë evidencë dhe kryejnë paraqitje të obligimeve të marra shumëvjeçare (formulari PO1) dhe obligimeve të marra për vitin aktual ((formulari O1).

Mënyrën e veprimit gjatë paraqitjes së obligimeve të marra shumëvjeçare (formulari PO1) dhe obligimeve të marra për vitin aktual ((formulari O1), si dhe mbajtjen e evidencës së obligimeve nga paragrafi (1) i këtij neni, e përcakton ministri i Financave.

5. REALIZIMI I SHPENZIMEVE NGA LLOGARITË E SHFRYTËZUESVE BUXHETORË NË BAZË TË ARKËTIMIT TË DETYRUESHËM

Neni 59

Mjetet për pagesë sipas urdhëresave për përmbarim (aktvendimeve për arkëtim të detyrueshëm dhe urdhëresave për përmbarim, të dorëzuara nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut) realizohen nga zëri 465–Pagesa për dokumente përmbaruese.

Për realizimin e urdhëresave për përmbarim-specifikimeve, Ministria e Financave me detyrë zyrtare kryen ridedikim të zërit 465-Pagesa për dokumente përmbaruese në shumë të shumës së nevojshme nga zërat e tjerë, ku ka mjete në dispozicion në kuadër të buxhetit të shfrytëzuesit buxhetor, përveç nga zërat për pagesë të pagave dhe kompensimeve, pavarësisht nga baza e dokumentit përmbarues.

Me përjashtim të paragrafit (2) të këtij neni, për ndarjen 090.02 - Ministria e Financave - Funksionet e shtetit, do të zbatohet neni 28 i këtij ligji.

6. DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 60

Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022 do të realizohet nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2022.

Neni 61

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, ndërsa do të zbatohet nga 1 janari 2022.